

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 78, datë 29.07.2024

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 75, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET Z. XHEVDET KACMOLI, ZNJ. VILMA KACMOLI DHE ZNJ. ORNELA KONDAKÇIU SI DHE NR. 107, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET Z. DEMIR DEMAJ

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njesisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në lagjen nr. 17, Njësia Administrative nr. 5, Rruga “Lura”, Pallati nr. 3 dhe Rruga “Ahmet Dakli”, Pallatet nr. 15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 19.10.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësine Administrative nr. 5, 6, Rrashbull, Katund i Ri dhe Manëz, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës

“Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 28.06.2021 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Xhevdet Kacmoli, znj. Vilma Kacmoli dhe znj. Ornela Kondakçiu në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 19.10.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Demir Demaj në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.07.2024




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 446 / prot.

Durrës, më 01.08 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.78 datë 29.07.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 75, datë 28.06.2021 përsa i përket Z.Xhevdet Kacmoli, Znj.Vilma Kacmoli Dhe Znj.Ornela Kondakçiu si dhe nr.107, datë 19.10.2022 përsa i përket Z. Demir Demaj”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

